



UK Shkoder

Ujësjetës Kanalizime Shkodër

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 2826 Prot
Shkodër, më 10.03.2016

Un. Prot. 385
Dt. 10.03.2016

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

BASHKISË SHKODËR

DHE

UJËSJELLËS-KANALIZIME SHKODËR SH.A

"Mbi funksionimin e Zyrave ne Sherbim te Arkave te UKSH nw NJA"

E lidhur sot me datën ____ . ____ .2016, mes palëve:

BASHKIA SHKODËR e përfaqësuar nga Kryetarja **znj. Voltana ADEMI**, me Adresë: Rruga '13 Dhjetori', Nr.1, SHKODËR, E-mail: info@bashkiashkoder.gov.al.

UJËSJELLËS-KANALIZIME SHKODËR SH.A me Nr.NIPTI J66902052A, përfaqësuar nga Administratori **z.Mark MOLLA**. Adresë: L. '3 Heronjt', Rr. 'Marin Biçikem', SHKODËR, E-mail: uks@ukshkoder-al.com.

BAZA LIGJORE: Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet në bazë të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar, VKM nr. 63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", VKB nr. 1 datë 22.01.2016, Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Shkodër.

OBJEKTI: Vënie në dispozicion të hapësirës së domosdoshme të zyrave për funksionimin administrativ dhe ofrimin e shërbimit në Njësitë Administrative, përkatësisht: pranë NJA Velipojë, NJA Dajç, NJA Bërdicë, NJA Ana e Malit, NJA Postribë, NJA Rrethina, NJA Guri i Zi, NJA Shkodër Qendër, me qëllim ushtrimin e aktivitetit: ARKA të UKSH, sipas objektit të veprimtarisë së regjistruar në QKB. dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore familjare të Bashkisë Shkodër.



Palët bien dakort sa më poshtë:

Neni 1

Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë Shkodër

1. Bashkia Shkodër do t'i japë në dispozicion Shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër **sh.a** sipërfaqen e nevojshme për ta përdorur në realizimin veprimtarisë së dhënies së shërbimit publik administrativ sipas objektit të veprimtarisë së regjistruar në QKB dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore familjare të Bashkisë Shkodër.
2. Bashkia Shkodër mund të kërkojë kthimin e menjehershëm të ambjentit apo hapësirës, si dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nese konstaton që Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a, nuk përmbush detyrimet e lartpërmendura.

Neni 2

Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a

1. Sipërfaqja e hapësirës për postet e punës në çdo Njësi Administrative, objekt i kësaj marrëveshje, pasi është parë nga të dy palët për gjendjen e saj teknike dhe funksionale, vendoset në funksion nga ana e Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a, e cila garanton se do ta përdorë atë vetëm për qëllimin e përcaktuar në marrëveshje.
2. Për çdo dëmtim të konstatuar të hapësirës në funksion të shërbimit publik, Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a, do të përgjigjet me vlerën e plotë të dëmit.
3. Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a, do ta përdor objektin vetëm për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën është realizuar kjo marrëveshje.
4. Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a, merr përsiper të kujdeset për ruajtjen e ambjenteve nga vjedhjet, dëmtimet, zjarri etj, si dhe çdo detyrim tjetër i parashikuar nga dispozitat ligjore në fuqi. Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a, detyrohet të mbajë dhe t'i ruajë ambjentet me perkujdesje.
5. Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a, nuk mund të përdorë ambjentet ndryshe nga përdorimi i caktuar në marrëveshje.
6. Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a, nuk mund t'ia japë një të treti ambjentet për përdorim pa pëlqimin e Bashkisë Shkodër.
7. Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a, është përgjegjës për humbjen ose dëmtimin e ambjenteve objekt i kësaj marrëveshje, përveç kur provon se humbja ose dëmtimi i sendit do të kishte ndodhur edhe në rast se nuk do të ishte dhënë në përdorim.

8. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a," është e detyruar që të paguajë me shpenzimet e veta shërbimet e mirëmbajtjes së zakonshme të ambjenteve dhe hapësirës në përdorim, përveç kur në marrëveshje është parashikuar ndryshe.

Neni 3

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast se midis palëve do të lindin mosmarrëveshje, të cilat nuk do të mund të zgjidhen në mirëkuptim midis tyre, atëherë secila nga palët ka të drejtë t'i drejtohet organeve kompetente, në mbështetje të legjislacionit në fuqi për zgjidhje.

Neni 4

Forcat madhore

Në rast se ndonjë nga palët e kësaj marrëveshje pengohet të përmbushë të gjitha ose një nga pjesët të detyrueshme të saj të parashikuara në këtë marrëveshje si pasojë e forcës madhore, kjo palë nuk do të jetë përgjegjëse për mospërmbushjen e detyrimeve të saj gjatë kohëzgjatjes së forcës madhore dhe për pasojat e shkaktuara dhe që rrjedhin nga forcat madhore.

Pezullimi i ekzekutimit të kësaj marrëveshje si pasojë e forcës madhore do të kufizohet në periudhën e kohës gjatë së cilës do të vazhdojnë efektet e forcës madhore.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje quhet e lidhur me nënshkrimin e saj nga palët .

Neni 6

Dispozita te fundit

Çdo korrigjim i marrëveshjes pas nënshkrimit të saj e bën atë të pavlefshme.

Kjo marrëveshje u hartua në katër kopje origjinale e cila pasi u lexua palëve, u pranua dhe u nënshkrua me vullnetin e tyre të plotë e të lirë.

Për Bashkinë Shkodër

Për Ujësjiellës-kanalizime Shkodër sha

Znj. Voltana ADEMI

Z. Mark Molla

Kryetare

Administrator